

Microsoft Albania sh.p.k.
Raporti i Auditorit të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2012

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Pasqyra e rrjedhës së parasë	5
Shënimet e pasqyrave financiare	6 – 25

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionarit dhe Drejtimit të Microsoft Albania sh.p.k.:

1. Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Microsoft Albania sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2012, pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

2. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, si dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e auditorit

3. Përgjegjësia jonë është që bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.
4. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimit apo i gabimit. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të projektojë procedura auditimi të cilat janë të përshatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
5. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të kualifikuar të auditimit.

Bazat për një opinion të kualifikuar

6. Siç është paraqitur në Shënimet 10 dhe 16 të pasqyrave financiare, Shoqëria ka paraqitur gjendje në shumën 4,392,695 Lek për "Llogaritë e arkëtueshme" dhe 18,923.103 Lek për "Të ardhura nga komisionet" nga Microsoft Corporation.

Megjithatë, shumat e konfirmuara nga Microsoft Corporation nëpërmjet dhomës ndërkombëtare të informacionit për Deloitte, në lidhje me transaksionet me palët e lidhura, ndryshojnë në mënyrë materiale nga ato të regjistruara në pasqyrat financiare. Mbështetur në këtë konfirmim, gjendja e llogarisë "Llogari të arkëtueshme" është zero, "Llogaritë e pagueshme" janë për shumën 3,111.359 Lek (USD 31,375) dhe shuma për llogarinë "Të ardhura nga komisionet" është 14,022,693 Lek. Për më tepër, nuk kemi marrë asnjë konfirmim nga Microsoft Ireland. Mbështetur në sa më sipër dhe në mungesë të procedurave alternative ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse shumat e paraqitura në pasqyrat financiare për llogaritë "Llogari të arkëtueshme" dhe "Të ardhurat nga komisionet" nga Microsoft Corporation janë paraqitur ashtu siç duhet dhe nëse ndonjë rregullim i mundshëm është i nevojshëm.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së diskutuar në paragrafin 6, në Bazat për një Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Microsoft Albania sh.p.k më 31 dhjetor 2012, rezultatin financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Albania sllpk

8 korrik 2013
Tiranë, Shqipëri

Microsoft Albania sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Aktivët			
Aktive afatgjata materiale	6	4,143,816	5,904,225
Totali i aktiveve afatgjata		4,143,816	5,904,225
Aktive ne proces	7	4,161,127	-
Aktive tatimore të shtyra	8	1,226,360	908,432
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	4,038,247	4,268,061
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	4,400,695	8,142,166
Tatim mbi fitimin i arkëtueshëm		-	812,744
TVSH e arkëtueshme	11	1,585,371	103,486
Paraja dhe ekuivalentet e saj	12	27,126,180	20,254,076
Totali i aktiveve afatshkurtra		42,537,980	34,488,965
Totali i aktiveve		46,681,796	40,393,190
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	13	100,000	100,000
Fitim i pashpërndarë nga vitet e kaluara		9,984,346	10,130,175
Fitimi i vitit		14,240,095	(145,829)
Totali i kapitalit		24,324,441	10,084,346
Hua nga institucione financiare	14	2,116,207	2,222,203
Totali i detyrimeve afatgjata		2,116,207	2,222,203
Të ardhura të shtyra	7	3,467,605	-
Pjesa afatshkurtër e huave nga institucionet financiare	14	1,304,374	6,459,025
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	15	15,213,073	21,627,616
Tatim mbi fitimin i pagueshëm		248,096	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		20,241,148	28,086,641
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		46,681,796	40,393,190

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm më 30 mars 2013 dhe janë firmosur nga:

ARSEN KURTI
 Drejtor i Përgjithshëm



ENKELEDA STEFANI
 Kontabiliste

Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Shitje neto	16	85,306,127	84,520,763
Shpenzime zhvlerësimi	7	(3,733,924)	(5,639,468)
Shpenzime personeli	17	(14,797,345)	(12,443,514)
Shpenzime operative të tjera	18	(49,772,221)	(62,826,218)
Fitimi operativ		17,002,637	3,611,563
Kosto financiare, neto		(338,744)	(942,697)
Humbja nga kursi i këmbimit, neto	19	(294,741)	(2,297,141)
Fitimi para tatimit		16,369,152	371,725
Shpenzimi i tatim fitimit	20	(2,129,057)	(517,554)
Fitim / (humbja) neto për vitin		14,240,095	(145,829)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) gjithëpërfshirëse		14,240,095	(145,829)

Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.
 Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
 (Të gjitha shumat janë në Lek)

	Kapitali aksionar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2011	100,000	10,130,175	10,230,175
Humbja neto e vitit	-	(145,829)	(145,829)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2011	100,000	9,984,346	10,084,346
Fitimi neto i vitit	-	14,240,095	14,240,095
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2012	100,000	24,224,441	24,324,441

Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
AKTIVITETE OPERATIVE			
Fitimi para tatimit		16,369,152	371,724
Rregullime për:			
Zhvlerësimi	6	3,733,924	5,639,468
Humbje nga kursi i këmbimit		294,741	2,297,141
Fitim nga shitja e aktiveve me qira financiare		-	(210,992)
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		20,397,817	8,097,341
<i>Ndryshimi në aktive dhe detyrime operative:</i>			
Ndryshim në aktive ne proces		(4,161,127)	-
Ndryshim në parapagime dhe shpenzime të shtyra		229,815	(3,244,575)
Ndryshim në llogari të arkëtueshme të tjera		(987,070)	21,276,127
Ndryshim në llogari të arkëtueshme tregtare		3,741,470	3,670,544
Ndryshim në të ardhura të shtyra		3,467,605	-
Ndryshim në të pagueshme tregtare dhe të tjera		(7,196,101)	(11,348,874)
Tatim fitimi i paguar		(1,386,144)	(1,865,836)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur në veprimtaritë operative		14,401,006	16,584,728
AKTIVITETE INVESTUESE			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(1,973,514)	(1,877,606)
Të ardhura nga shitja e aktiveve me qira financiare		-	536,000
Rrjedhja e parasë neto e përdorur në aktivitetet investuese		(1,973,514)	(1,341,606)
AKTIVITETE FINANCUESE			
Ripagime të huave		-	(1,345,400)
Ripagime të qirasë financiare		(5,260,647)	(2,775,263)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur në aktivitetet e financimit		(5,260,647)	(4,120,663)
Rritje neto e parasë dhe ekuivalentet e saj		6,872,104	11,122,458
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	12	20,254,076	9,131,618
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	12	27,126,180	20,254,076

Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITSHME

Microsoft Albania ("Shoqëria") u themelua më 30 qershor 2008 si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe u regjistrua sipas vendimit të gjykatës në të njëjtën datë, me NIPT: K8183001C dhe numër serial certifikate: SN-055925-05-09.

Aksionari i Shoqërisë është Microsoft Corporation, e cila zotëron 100% të aksioneve. Microsoft është një korporatë software-sh me bazë në SHBA, e regjistruar më 22 shtator 1993, me seli në Redmond, Washington.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve të marketingut, lokalizimit dhe shërbime të lidhura me programe kompjuterike dhe hardware, duke përfshirë pa asnjë kufizim shërbimin teknik, trajnimin dhe këshillimin.

Më 31 dhjetor 2012 Shoqëria kishte 3 punonjës (2011: 3). Zyrat e Shoqërisë ndodhen në Rrugën Abdyl Frashëri, P.11/1, EGT Tower Kati 2, Tiranë, Shqipëri.

Drejtesit dhe Manaxherët më 31 dhjetor 2012 dhe 2011:

Benjamin Owen Orndorff	Administrator
Keith Ranger Dolliver	Administrator
Arsen Kurti	Drejtor për degën e Shqipërisë
Biljana Weber	Përfaqësues ligjor

2. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA

2.1 Standardet dhe interpretimet e publikuara por ende jo në fuqi

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet dhe interpretimet e mëposhtme ishin të publikuara por ende jo në fuqi:

- SNRF 9 "Instrumentat Financiare" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2015),
- SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013),
- SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirjet në shoqëritë e tjera" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013),
- SNRF 13 "Matja e vlerës së drejtë" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013),
- SNK 27 (i rishikuar në 2011) "Pasqyrat financiare individuale" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013),
- SNK 28 (i rishikuar në 2011) "Investime në Shoqëri dhe Sipërmarrje të përbashkëta" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013),

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

2.1 Standardet dhe interpretimet e publikuara por ende jo në fuqi (vazhdim)

- Ndryshime në SNRF 1 “Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë” – Huatë qeveritare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese” - Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- Ndryshime në SNRF 9 “Instrumentat financiarë” dhe SNRF 7 “Instrumentat financiarë - Dhënia e informacioneve shpjeguese” – Data e detyrueshme e hyrjes në fuqi dhe paraqitjet e kalimet.
- Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara”, SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta” dhe SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” – Udhëzim për kalimin (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara”, SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” dhe SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale” – Shoqëritë investuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare” – Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përnblëdhëse (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2012),
- Ndryshime në SNK 19 “Përfitimet e punonjësve” – Përmirësime të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- Ndryshime në SNK 32 “Instrumentat financiarë: paraqitja” – Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- Ndryshime në disa standarde “Përmirësime në SNRF (2012)” që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve të publikuara më 17 maj 2012 (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- KIRFN 20 “Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqeje miniere” – (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

Shoqëria ka zgjedhur të mos i aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave efektive të tyre. Shoqëria thekson se adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në momentin e aplikimit fillestar.

2.2 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Ndryshimet e standardeve ekzistuese në vijim të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabiliteti janë efektive për periudhën aktuale:

- Ndryshime në SNRF 1 “Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë”- Hiperinflacioni i rëndë dhe heqja e datave fikse për adoptuesit për herë të parë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale (vazhdim)

- **Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese”**- Transferimi i aktiveve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- **Ndryshime në SNK I2 “Tatimet mbi të ardhurat”** – Tatimi i shtyrë: Mbulimi i aktiveve kryesore (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2012),

Aplikimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka sjellë asnjë ndryshim të rëndësishëm në politikat kontabël të Shoqërisë.

2. BAZAT E PËRGATITJES

3.1 Deklarata e përpuethshmërisë

Në përputhje me Ligjin Nr. 9228, datë 29 prill 2004 “Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur me koston historike.

3.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur dhe paraqitur në Lek që është monedha e mjedisit ekonomik primar në të cilin Shoqëria kryen aktivitetin e saj.

3.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

3. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

3.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Gjykimet

Në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë, Drejtimi ka bërë gjykimin në vijim, përveç atyre që përfshijnë vlerësime (shih më poshtë), i cili ka efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare:

Njohja e aktivitetit tatimor të shtyrë

Njohja e aktivitetit tatimor të shtyrë bazohet në faktin nëse ka më shumë mundësi se do të ketë fitime të mjaftueshme dhe të përshtatshme në dispozicion në të ardhmen, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme. Njohja pra, përfshin gjykim në lidhje me rezultatet e ardhshme të Shoqërisë.

Vlerësimet dhe supozimet

Supozimet kryesore për të ardhmen dhe burimet e tjera të rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë në fund të periudhës raportuese, të cilat kanë rrezik të konsiderueshëm për shkaktimin e një rregullimi material në shumat e mbetura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë.

Jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale

Kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale përfshin përdorimin e vlerësimeve për përcaktimin e jetëgjatësisë të këtyre aktiveve si dhe vlerat e rikuperueshme të tyre. Përcaktimi i jetëgjatësive të këtyre aktiveve bazohet në gjykimin e Drejtimit. Jetëgjatësitë paraqiten në shënimin 4.3. Shoqëria i rishikon këto vlerësime në fund të çdo periudhe raportimi.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

4.1 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek ("monedha funksionale") me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë në monedhë të huaj janë konvertuar në Lek me normat e datës së raportimit. Zërat jo-monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë që janë në monedhë të huaj janë konvertuar me normën në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë të cilët janë matur në koston historike në monedhë të huaj nuk janë konvertuar.

Diferencat e konvertimit që lindin nga shlyerja e zërave monetarë dhe nga rikonvertimi i zërave monetarë, janë të përfshira në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave për periudhën.

Kursi efektiv në fund viti midis Lek-ut dhe monedhave të tjera është si më poshtë:

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
USD	105.85	107.54
EUR	139.59	138.93

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat e parave në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e caktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuese të instrumentit. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të parasë u mbaron afati, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhat kontraktuale të parasë të aktiveve financiare në një transaksion në të cilin të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së aktiveve financiare janë transferuar. Çdo interes mbi aktivet financiare të transferuara që është krijuar, ose mbahet nga Shoqëria është i njohur si një aktiv ose detyrim i veçantë. Aktivet dhe detyrimet financiare janë kompesuar dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompesuar shumat dhe ka për qëllim ose për të zgjidhur në baza neto ose për të njohur aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, paraja dhe ekuivalentet e saj, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera dhe huatë.

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë paranë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht sipas vlerës së drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjen nga rënia në vlerë.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë paraqitur në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke njohur shpenzime interesi sipas bazës së interesit efektiv.

Metoda e normës së interesit efektiv

Metoda e normës së interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për shpërndarjen e shpenzimit të interesit mbi periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, aty ku është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet financiare është diskutuar në politikën kontabël 4.7.

4.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo rënie në vlerë të akumuluar.

Kosto përfshin shpenzimin që është direkt i përfshirë në blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe koston direkte të punës, çdo kosto tjetër të përfshirë direkt në sjelljen e aktivit në kushte pune për qëllimin e përcaktuar, koston e çmontimit dhe largimit të pjesëve dhe restaurimit të vendit në të cilin ato janë vendosur si dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Njohja dhe matja (vazhdim)

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme kontabilizohen si elemente të veçanta (komponent kryesor) të aktiveve afatgjata materiale. Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivi afatgjatë material përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja e aktivit afatgjatë material me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto në të ardhura të tjera në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

(iii) Kostot vijuese

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tyre mund të maten në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbiemeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

(iv) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet mbi vlerën e zhvlerësueshme, e cila është kosto e një aktivi, ose një vlerë zëvendësuese e kostos, minus vlerën e tij të rikuperueshme. Zhvlerësimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sipas bazës lineare përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të secilit grup të aktiveve afatgjata materiale, duke qenë se kjo e reflekton më mirë modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të trupëzuara në një aktiv. Toka nuk zhvlerësohet. Jetëgjatësitë e vlerësuar për periudhën aktuale si dhe për periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Kategoritë	Vitet
Pajisje zyre	3
Automjete	3
Mobilje dhe orendi	3
Pajisje dhe programe kompjuterike	1-2

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësitë dhe vlerat e rikuperueshme rishikohen në fund të çdo viti financiar si dhe bëhen rregullime nëse është e përshtatshme.

4.4 Rënia në vlerë

Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë përmes fitim/humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar ka rënie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënie në vlerë së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë nga aktivi, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.4 Rënia në vlerë (vazhdim)

Humbja nga rënia në vlerën e aktivit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave (në humbje ose fitim) dhe reflektohen në një llogari provigjoni të kundërt me llogaritë e arkëtueshme. Interesi nga aktivet e zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

Aktivitet jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse një e dhënë e tillë ekziston, në këtë rast vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontohen me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njërive të saj gjeneruese të parasë e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave (në humbje ose fitim).

4.5 Njohja e të ardhurave

E ardhura është hyrja bruto e përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, e cila gjenerohet përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë. E ardhura matet me vlerën e drejtë të drejtave të arketuara ose që priten të arkëtohen. E ardhura zvogëlohet me vlerën e kthimeve të vlerësuarat të klientëve, rabateve dhe zbritjeve të ngjashme, nëse ka.

E ardhura në lidhje me komisionet nga Microsoft Corporation që ka të bëjë me aktivitetet e marketingut, kërkimit dhe zhvillimit njihet kur shpenzimet e lidhura me to ndodhin.

E ardhura nga shërbimet ndaj palëve të treta bazuar në kontratat e shërbimeve njihet në bazë të fazës së përfundimit të kontratës së shërbimit.

Kur shërbimet janë kryer nga një numër i pacaktuar veprimesh përgjatë një periudhe të caktuar kohe, e ardhura njihet mbi bazë lineare përgjatë periudhës së specifikuar për atë kohë sa nuk ka dëshmi se një metodë tjetër e përfaqëson më mirë fazën e përfundimit.

4.6 Qiratë

Qiratë klasifikohen në qira financiare në çdo rast që kushtet e marrëveshjes i transferojnë qiramarrësit të gjitha të drejtat dhe rreziqet nga pronësia. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operative.

Aktivitet e mbajtura sipas një marrëveshjeje qiraje financiare njihen si aktive të Shoqërisë me vlerën e tyre të drejtë në datën e krijimit të marrëveshjes ose, nëse është më e vogël, me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë. Detyrimi përkatës kundrejt qiramarrësit përfshihet në pasqyrën e pozicionit financiar si një detyrim për qira financiare.

Pagesat e qirasë ndahen midis pagesave të interesit dhe pakësimeve të detyrimit për qira në mënyrë që të arrihet një normë konstante interesi për vlerën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare njihen direkt në humbje ose fitim.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.6 Qiratë (vazhdim)

Pagesat e bëra për qira operative njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sipas bazës lineare përgjatë periudhës së qirasë.

4.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë nëpër banka si dhe të ardhurat nga kurset e këmbimit, të cilat njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në aktivet financiare njihet në të ardhurat nga interesi.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa mbi huatë dhe detyrimet mbi qiranë, si dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në detyrimet financiare njihet në shpenzimet për interes. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen sipas një baze neto.

4.8 Të ardhura dhe shpenzime të tjera

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara në momentin që shërbimet janë siguruar.

4.9 Tatime

Tatim fitimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave dhe përfaqëson shumën e tatimit të pagueshëm të periudhës dhe tatimin e shtyrë.

Tatimi i periudhës është tatimi i pagueshëm i pritshëm mbi fitimi e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit të zbatueshme në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim mbi tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sepse ai përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera si dhe përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

Tatimi i shtyrë regjistrohet duke përdorur metodën e bilancit dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar sipas diferencave të përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime fiskale.

Vlera e tatimit të shtyrë bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat e tatimit të miratuara dhe në fuqi në datën e raportimit.

Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjithë diferencën e përkohshme të tatueshme dhe aktivet për tatimin e shtyrë njihen vetëm në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë të disponueshme, kundrejt të cilave mund të aplikohen diferencat e përkohshme të zbritshme. Aktivet për tatimin e shtyrë zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi i lidhur me to të mund të realizohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që pritet të aplikohet në periudhën kur detyrimi shlyhet ose kur aktiviteti realizohet dhe ngarkohet ose kreditohet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, me përjashtim kur ai lidhet me zëra të cilët ngarkohen ose kreditohen direkt në kapital, në këtë rast tatimi i shtyrë shpërndahet gjithashtu në kapital.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

5. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË

Disa nga politikat dhe paraqitjet e Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, edhe për aktivet dhe detyrimet financiare edhe për ato jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllimet e matjes dhe/ose paraqitjes, duke u bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, janë dhënë informacione shtesë në shënimet specifike të aktiveve dhe detyrimeve përkatëse mbi supozimet që janë bërë për përcaktimin e vlerës së drejtë të tyre.

(i) Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera është e përcaktuar si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit. Kjo vlerë e drejtë përcaktohet për qëllime të paraqitjes.

(ii) Detyrimet financiare jo-derivative

Vlera e drejtë, e cila përcaktohet për arsye të paraqitjes, llogaritet duke u bazuar në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të principalit dhe interesit, të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit. Për qiratë financiare norma e interesit e tregut përcaktohet duke u bazuar në marrëveshjet e ngjashme të qirasë.

Microsoft Albania sh.p.k.
 Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2012
 (Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto historike	Makina nën qira financiare	Pajisje zyre	Mobilje dhe orendi zyre	Të tjera	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2011	9,143,392	2,129,070	2,318,545	3,207,228	16,798,235
Shesa	1,141,448	600,916	231,150	-	1,973,514
Gjendja më 31 dhjetor 2012	10,284,840	2,729,986	2,549,695	3,207,228	18,771,749
Zhvlerësimi i akumuluar					
Gjendja më 31 dhjetor 2011	4,436,904	2,050,585	2,145,200	2,261,320	10,894,010
Zhvlerësimi i vitit	2,131,724	588,220	176,851	837,128	3,733,923
Gjendja më 31 dhjetor 2012	6,568,628	2,638,806	2,322,051	3,098,448	14,627,933
Vlera kontabël					
Më 31 dhjetor 2011	4,706,488	78,485	173,345	945,908	5,904,225
Më 31 dhjetor 2012	3,716,212	91,181	227,644	108,780	4,143,816

Microsoft Albania sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

7. AKTIVE NË PROCES

Kjo llogari përfaqëson faturën e lëshuar nga Shoqëria Next Sense, një Shoqëri e nënkontraktuar që kryen shërbimet MCS ndaj Qeverisë Shqiptare sipas një marrëveshje të kontraktuar për shërbimet që do kryhen në 2013. Megjithatë Shoqëria Next Sense ka kryer një pjesë të punës gjatë vitit 2012 dhe ka lëshuar një faturë ndaj Microsoft Albania sh.p.k. në shumën 27,918 USD (2,955 mijë Lek). Shuma prej 4,161,127 Lek e klasifikuar si aktive në proces, është llogaritur si shuma e faturuar prej 27,918 USD plus 20% TVSH dhe 18% komision shtesë nga Shoqëria Mëmë mbi çdo shpenzim të ndodhur.

Qeveria Shqiptare nuk e njej punën e kryer për aq kohë sa nuk është përfunduar.

8. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA

Aktivitet tatimore të shtyra janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Tatime të shtyra që lindin nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata mbi normat e lejuara	677,286	616,079
Tatime të shtyra që lindin nga bonuset e përlllogaritura	353,923	292,353
Shpenzime marketingu të shtyra	153,233	-
Aktive të tjera të shtyra	41,918	-
Totali	1,226,360	908,432

Lëvizjet në aktivitet tatimore të shtyra:

	2012	2011
Gjendja në fillim të vitit	908,432	347,793
Kredituar tek pasqyra gjithpërfshirëse e të ardhurave (shënimi 20)	317,928	560,640
Gjendja në fund të vitit	1,226,360	908,432

9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Shpenzime të shtyra	3,250,747	3,932,561
Garanci për qira	787,500	277,200
Parapagime furnitorëve	-	58,300
	4,038,247	4,268,061

Garancia për qiranë e zyrave është dhënë në përputhje me kontratën e firmosur. Shpenzimet e shtyra përfshijnë shpenzimet e shtyra për nën-kontraktuesin, Next Sense, të punësuar për të përfunduar kontratën MSC me Qeverinë Shqiptare.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Microsoft Ireland	4,392,695	6,001,957
Raiffeisen Bank	-	1,404,042
Tetra Solution	-	387,144
Helwet Packard	-	340,800
Të tjera	8,000	8,223
Totali	4,400,695	8,142,166

11. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
TVSH e arkëtueshme	1,585,372	68,867
Debitorë të tjerë	-	34,619
Totali	1,585,372	103,486

12. PARAJA DHE EKVIVALENTET E SAJ

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Para në arkë	13,735	154
Para në bankë	27,112,445	20,253,922
<i>Llogari rrjedhëse në LEK</i>	<i>22,345,568</i>	<i>19,010,121</i>
<i>Llogari rrjedhëse në USD</i>	<i>4,766,877</i>	<i>1,243,801</i>
Totali	27,126,180	20,254,076

13. KAPITALI AKSIONAR

	31 dhjetor 2012		31 dhjetor 2011	
	Numri i aksioneve	Lek	Numri i aksioneve	Lek
Microsoft Corporation	100	100,000	100	100,000
	100	100,000	100	100,000

Bazuar në vendimin e gjykatës të datës 30 qershor 2008, Shoqëria është regjistruar me kapital të paguar prej 100,000 Lek i ndarë në 100 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secila. Microsoft Corporation zotëron 100% të aksioneve.

Microsoft Albania sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

14. HUA NGA INSTITUCIONET FINANCIARE

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
<i>Pjesa afatgjatë, 1 deri në 5 vjet</i>		
Detyrimet nga qiraja financiare (ii)	2,116,207	2,222,203
	<u>2,116,207</u>	<u>2,222,203</u>
<i>Pjesa afatshkurtër, deri në një vit</i>		
Microsoft Global Finance Ltd (i)	-	4,369,846
Detyrimet nga qiraja financiare (ii)	1,304,374	2,089,179
	<u>1,304,374</u>	<u>6,459,025</u>
Totali	<u>3,420,581</u>	<u>8,681,228</u>

i. Huatë

Shoqëria ka nënshkruar tre marrëveshje kredie me Microsoft Global Finance, një nga shoqëritë e Grupit të Microsoft, për një total prej 8,700,775 Lek, e cila mbart interes me normë fikse. Huaja është paguar gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2012 dhe është zero më 31 dhjetor 2012.

ii. Qiraja financiare

Më 24 dhjetor 2008, Shoqëria nënshkroi dy marrëveshje qiraje financiare me Raiffeisen Leasing sh.a. për blerjen e dy automjeteve, njëra nga të cilat u nxorr jashtë përdorimit gjatë vitit 2011. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2011, Shoqëria ka blerë dy automjete të reja nga Tirana Leasing që mbart një normë nominale interesi të barabartë me EURIBOR 12 mujor + 5%. Nuk është blerë asnjë automjet i ri gjatë vitit 2012.

15. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Të ardhura të shtyra	6,271,266	4,183,746
Detyrime ndaj personelit	3,626,479	3,608,173
Detyrime ndaj furnitorëve (i)	3,174,666	13,651,576
Shërbime të pafaturuara	1,951,509	-
Detyrime të tjera tatimore (ii)	189,153	184,121
Totali	<u>15,213,073</u>	<u>21,627,616</u>

Shërbimet e pafaturuara përfaqësojnë kryesisht shpenzime të shtyra me qëllime marketingu.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

15. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA (VAZHDIM)

(i) Detyrime ndaj furnitorëve

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Next Sense	2,955,188	12,355,932
ISSETI	163,621	163,620
Tech-Fly	-	270,000
Semos ALTS	-	163,944
Furnitorë të tjerë	55,857	698,080
Totali	3,174,666	13,651,576

(ii) Detyrime të tjera tatimore

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Tatimi mbi të ardhurat personale	112,597	110,716
Sigurime shoqërore	76,556	73,405
Totali	189,153	184,121

16. SHITJE NETO

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Të ardhura nga komisionet	18,823,102	50,314,782
Të ardhura nga shërbimet	66,483,025	34,205,981
Totali	85,306,127	84,520,763

Të ardhurat nga shërbimet përfaqësojnë komisionet e marra nga Microsoft Corporation në lidhje me marketingun dhe aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit të kryera nga Shoqëria. Komisionet llogariten bazuar në shpenzimet mujore për marketingun dhe përpjekjet kërkimore, duke përfshirë kostot e ndodhura për të siguruar të ardhurat nga burime të tjera, me një shtesë marzhi prej 13% mbi kostot totale.

E ardhura nga shërbimet lidhet me shërbimet e ofruara ndaj palëve të treta për mbështetje teknike dhe shërbime këshilluese. Ka dy lloje kontratash respektivisht, të cilat ndryshojnë sipas llojit të shërbimit dhe politikave të njohjes së të ardhurave. "Premier Services" është një shërbim i parapaguar që ofron mbështetje teknike brenda një periudhe njëvjeçare, e matur me 12 pagesa të njëjta për produktet e Microsoft; ndërsa "Microsoft Consulting Services" ofron këshillim për projekte specifike që të zbatohen sipas marrëveshjes dhe matet bazuar në fazën e përfundimit.

Microsoft Albania sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

17. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Paga dhe përfitime të tjera	14,258,745	12,067,528
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	538,600	375,986
Totali	14,797,345	12,443,514

Paga dhe përfitime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012, përfshijnë bonuset në shumën 909,558 Lek (2011: 1,883,490 Lek).

18. SHPENZIME OPERATIVE TË TJERA

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Shpenzime reklame	14,090,290	14,875,574
Shërbime ligjore dhe financiare	11,061,826	9,924,460
Shërbime të nënkontraktuara	10,312,883	20,685,677
Qira	3,781,205	3,809,302
Udhëtime dhe dieta	3,423,679	4,787,283
Internet	911,872	1,354,201
Energji dhe ujë	760,205	627,629
Telefon	699,706	619,166
Pritje dhe dhurata	666,629	1,749,939
Sigurime	546,913	95,594
Shërbime bankare	456,502	649,395
Mirëmbajtje	344,217	544,912
Pajisje zyre	274,777	327,828
Shërbime postare	115,344	84,570
Telefon zyre	107,168	113,399
Gjoha	55,950	76,971
Shpenzime trajnimi	-	603,690
Shpenzime të tjera	2,163,055	1,896,629
Totali	49,772,221	62,826,219

Shpenzime të tjera përfshin shpenzime të përllogaritura për shpërblime dhe pushime, shpenzime auditimi, taksa reklamash, shpenzime parkingu, etj.

19. FITIM/(HUMBJE) NGA KURSI I KËMBIMIT, NETO

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Humbje nga kursi i këmbimit	(1,171,815)	(2,569,569)
Fitimi nga kursi i këmbimit	877,074	272,428
Totali	(294,741)	(2,297,141)

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

20. TATIMI MBI FITIM

Tatimi mbi fitim për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 dhe 2011 është i përbërë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Shpenzimi për vitin me 10% (2011: 10%)	(2,446,985)	(1,078,193)
Tatimi i shtyrë: lindja dhe anulimi i diferencave kohore	317,928	560,639
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(2,129,057)	(517,553)

Norma standarde e tatimit për vitin, bazuar në normën standarde shqiptare të tatimit mbi fitimin është 10% (2011: 10%). Shpenzimi për vitin mund të rakordohet me fitimin kontabël si në vijim:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2012	Norma efektive e tatimit	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2011	Norma efektive e tatimit
Fitimi para tatimit	16,369,152		371,724	
Tatimi mbi fitimin	1,636,915	10%	37,172	10%

Efekti tatimor i:

Shpenzimeve të pazbritshme	810,070	5%	1,041,020	280%
Efekti i mbartjes së humbjeve tatimore	(317,928)	(2%)	(560,639)	(151%)
Shpenzimi i tatim fitimit i njohur në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave	2,129,057	13%	517,554	139%

Shpenzimet e pazbritshme përfaqësojnë kryesisht shpenzimet për shpërblime dhe pushime për punonjësit, marketing dhe reklamë, diferencën ndërmjet zhvlerësimit manaxherial dhe statutor, korrigjimin e gabimeve të periudhave të mëparshme.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

21. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Llogari të arkëtueshme:		
Microsoft Ireland Operations Ltd.	4,392,695	6,001,957
Totali	4,392,695	6,001,957
Huatë:		
Microsoft Global Finance Ltd	-	6,494,709
Totali	-	6,494,709
Totali	4,392,695	12,496,666

Gjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksionet e mëposhtme me Microsoft Corporation dhe Microsoft Ireland Operations Lmtd.:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Komisione	18,823,103	50,314,782

22. ANGAZHIME DHE GARANCI

Angazhime në qira operative

Më 31 dhjetor 2012 dhe 2011 Shoqëria është palë e marrëveshjes për qira operative për marrjen me qira të zyrave, e cila skadon më 1 mars 2014. Pagesat minimale të ardhshme për këto marrëveshje janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Brenda një viti	1,304,374	3,410,019
Pas një viti, por jo më shumë se 5 vjet	2,116,207	3,978,356
Totali	3,420,581	7,388,375

Çështje gjyqësore

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procesi gjyqësor, padie apo çështje gjyqësore të ngritur gjatë aktivitetit normal të biznesit.

23. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas datës së raportimit nuk ka patur ndonjë ngjarje, e cila do të kërkonte ndryshime apo paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

24. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Një instrument financiar është çdo kontratë që bën të mundur krijimin e një të drejte për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar), ose krijimin e një detyrimi për t'i transferuar mjete monetare ose aktive të tjera financiare një pale tjetër (detyrim financiar). Instrumentet financiarë e ekspozojnë Shoqërinë ndaj disa rreziqeve. Më të rëndësishmet janë paraqitur më poshtë.

24.1 Rreziku i kredisë

Instrumentet financiarë, të cilat e bëjnë Shoqërinë subjekt të rrezikut të kredisë, konsistojnë kryesisht në llogari të arkëtueshme të tjera dhe mbajtje të parave. Rreziku i kredisë i Shoqërisë manaxhohet duke vendosur mjetet e saj monetare në institucione financiare me cilësi të lartë.

Maksimumi i rrezikut të kredisë ndaj të cilës Shoqëria është e ekspozuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar është si më poshtë:

	31dhjetor 2012	31dhjetor 2011
Llogari të arkëtueshme tregtare	4,400,695	8,142,166
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,585,372	103,486
Para në bankë	27,112,445	20,253,922
Totali	33,098,512	28,499,574

24.2 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria siguron vazhdimësi të financimeve. Huatë e saj janë të ndara në hua dhe qira financiare. Fleksibiliteti afatshkurtër arrihet duke mbajtur mjete të mjaftueshme monetare dhe duke përdorur lehtësirat e overdraftit, sipas nevojës.

Më poshtë janë paraqitur maturitetet e kontraktuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare, duke përfshirë edhe pagesat e interesit deri më 31 dhjetor 2012 dhe 2011:

31 dhjetor 2012	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se 1 vit
<i>Aktive financiare</i>				
TVSH e arkëtueshme	1,585,372	-	1,585,372	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	4,400,695	4,400,695	-	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	27,126,180	27,126,180	-	-
Totali	33,112,247	31,526,875	1,585,372	-
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua nga institucionet financiare	3,420,581	-	1,304,374	2,116,207
Llogari të pagueshme dhe të tjera	15,213,073	15,213,073	-	-
Totali	18,633,654	15,213,073	1,304,374	2,116,207
Pozicioni neto	14,478,593	16,313,802	280,998	(2,116,207)

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

24. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

24.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2011	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se 1 vit
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme të tjera	103,486	-	103,486	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	8,142,166	8,142,166	-	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	20,254,076	20,254,076	-	-
Totali	28,499,728	28,396,242	103,486	-
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua nga institucionet financiare	2,222,203	-	-	2,222,203
Pjesa afatshkurtër e huave	6,459,025	-	6,459,025	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	21,627,616	21,627,616	-	-
Totali	30,308,844	21,627,616	6,459,025	2,222,203
Pozicioni neto	(1,809,116)	6,768,626	(6,355,539)	(2,222,203)

24.3 Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga kurset e këmbimit sidmos në lidhje me financimet përmes qirave financiare. Këto marrëveshje më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011 janë kryer në Euro. Shoqëria nuk ka përdorur instrumentë derivativë për të kufizuar ekspozimin e saj ndaj rrezikut nga kurset e këmbimit dhe normat e interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë sipas monedhave më 31 dhjetor 2012 dhe 2011 janë si më poshtë:

December 31, 2012	Vlera kontabël	EURO	USD	Lek
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme të tjera	1,585,372	-	-	1,585,372
Llogari të arkëtueshme tregtare	4,400,695	-	4,392,335	7,640
Paraja dhe ekuivalentet e saj	27,126,180	-	4,766,877	22,359,303
	33,112,247	-	9,159,212	23,952,314
<i>Detyrime financiare</i>				
Huatë nga institucionet financiare	3,420,581	3,420,581	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	15,213,073	-	2,955,188	12,257,885
	18,633,654	3,420,581	2,955,188	12,257,885
Ekspozimi neto	14,478,593	(3,420,581)	6,204,024	11,694,430

Microsoft Albania sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

24. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

24.3 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

31 dhjetor 2011	Vlera kontabël	EURO	USD	Lek
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme të tjera	103,486	-	-	103,486
Llogari të arkëtueshme tregtare	8,142,166	-	7,793,143	349,023
Paraja dhe ekuivalentet e saj	20,254,076	-	1,243,801	19,010,274
	28,499,728	-	9,036,944	19,462,783
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua afatnesme	2,222,203	2,222,203	-	-
Pjesa afatshkurtër e huave	6,459,025	2,089,178	-	4,369,847
Llogari të pagueshme dhe të tjera	21,627,616	-	12,355,932	9,271,684
	30,308,844	4,311,381	12,355,932	13,641,531
Ekspozimi neto	(1,809,116)	(4,311,381)	(3,318,988)	5,821,252

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutave të huaja

Analiza e ndjeshmërisë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhave të huaja në datën e raportimit dhe ndryshimet e parashikuara në fillim të vitit financiar dhe të mbajtura konstante gjatë periudhës së raportimit. Më poshtë është vlerësimi i efekteve të ndryshimit të kurseve të këmbimit në fitimin neto, duke mbajtur të gjitha variablat e tjera konstante. Tabela tregon fitimin (humbjen) në Lek kur monedhat e huaja (EURO, USD) vlerësohen ose zhvlerësohen me 10% kundrejt Lekut.

	2012		2011	
	EUR	USD	EUR	USD
Monedha zhvlerësohet me 10%	342,058	(620,438)	431,138	331,898
Monedha vlerësohet me 10%	(342,058)	620,438	(431,138)	(331,898)

24.4 Rreziku i normave të interesit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të interesit të lidhur me instrumentet financiare që kanë normë të ndryshueshme interesi. Më 31 dhjetor 2012, Shoqëria ka tre (2011: tre) marrëveshje qiraje financiare që kanë norma të luhatshme interesi, ashtu siç edhe përshkruhet në shënimin 13.